



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

**MANUAL PËR STUDENTË
(PËR CILËSI NË MËSIMXËNIE)**

Fjala e dekanit

Prof.Dr.Shyqeri Kabashi

Urime për zgjedhjen tuaj, për të studiuar në Kolegjin "Biznesi", dhe, në veçanti, për t'u bërë pjesë e Kolegjit në një nga programet e shkëlqyera që ofron ky Kolegj.

Ky manual synon t'ju ofrojë informacion se si të prodhoni punë cilësore dhe të arrini rezultate sa më mira në studimet tuaja.

Qëllimi kryesor i Kolegjit "Biznesi" është t'ju ndihmojë të përfitoni nga një arsim i shkëlqyer, në mënyrë që të mund të keni pozitën tuaj në shoqëri, si një i diplomuar i mirë-kualifikuar dhe shumë i aftë. Kolegji ofron mbështetjen e mësimdhënies dhe kornizën e nevojshme për studimet tuaja. Suksesi mund të arrihet vetëm përmes angazhimit dhe përkushtimit tuaj personal në punën e palodhur gjatë gjithë periudhës së studimeve së bashku me stafin tonë.

Ky manual me informacionin që përmban, ka për qëllim t'ju njohë me procesin e studimeve në Kolegjin "Biznesi", me mjedisin që do të keni në dispozicion dhe të sigurojë udhëzimet e nevojshme, për t'u shërbyer të rrisni efektivitetin tuaj të studimeve, në mënyrë që të arrini të realizoni potencialin e kërkesave ndaj vetes.

Për ju student që jeni duke provuar studimin për herë të parë, ky manual do të sigurojë një themel të rëndësishëm njohës për rrugën që duhet të ndiqni për t'u aftësuar që të përgatiteni për një botë e re.

Qëllimi i Manualit për Cilësi dhe përgatitje profesionale është t'ju ofrojë informacion praktik dhe lehtësisht të arritshëm në lidhje me procesin e studimit për të arritur nivel të lartë të edukimit. Ky manual do të iu ofrojë ide, sugjerime dhe udhëzime për t'ju mundësuar arritjen e suksesit akademik, duke bërë punë cilësore dhe duke qenë në gjendje ta paraqesin këtë punë në kohën e duhur.

Ne ju sugjerojmë ta lexoni Manualin dhe t'i referoheni gjatë gjithë procesit tuaj të studimit - por gjithashtu mos harroni se është vetëm një udhëzues i përgjithshëm!

Për kërkesat specifike, ju lutemi sigurohuni që t'u referoheni udhëzuesve të njësisve tuaja dhe menaxhimit të sistemi të të nxënit, për të marrë detaje specifike në lidhje me kërkesat e vlerësimit të secilës njësi.

Po qe se eventualisht keni ndonjë pyetje të mëtejshme, këshillohuni me stafin akademik përkatës, që është përgjegjës për njësitë tuaja.

Ju dëshiroj suksese.

Faleminderit!

Angazhimet tona:

Ne angazhohemi në kërkimin hulumtues dhe edukimin më cilësor të mundshëm për të arritur të kemi ndikim pozitiv në përgatitjen e kuadrove për të sjellë ndryshim në shtetin tonë, në rajon dhe më gjerë.

Vlerat tona:

Kolegji "Biznesi" njihet si një nga institucionet akademike kryesore në Kosovë, që ofron studime kualitative në rrafshin e ekonomisë, menaxhimit të emergjencave dhe në fushën juridike. Kolegji ofron bursa për studentë, punë praktike në sektorin publik dhe privat, lidhshmëri të studimeve në mbështetje të ekonomisë së tregut dhe trajnime profesionale në disa disiplina të ngjashme.

Programet dhe aktivitetet e Kolegjit deri me tani janë verifikuar nga ekspert të pavarur, partnerët tanë dhe nga ekspertë ndërkombëtarë, të cilat institucionin tonë e vlerësojnë mjaft pozitivisht në ofrimin e cilësisë për edukimin e brezave të rinj.

Vlerat tona specifike

Ne mbështesim e respektojmë vlerat e të drejtave të njeriut, drejtësinë sociale dhe diversitetin individual, ndjekim misionin dhe vizionin tonë, si dhe jemi të përkushtuar për të realizuar:

- sigurimin e një mjedisi të përbashkët dhe të përshtatshëm për të gjithë stafin dhe studentët;
- integritetin akademik, transparencën dhe përgjegjësinë në qeverisjen e brendshme të veprimtarisë së Kolegjit;
- njohjen dhe shpërblimin e ekselencës në kërkime, edukim dhe gjithçka që ndërmarrim e bëjmë për ofrimin e shërbimeve që do të jenë udhërrëfyes i shkencës dhe zhvillimit të njeriut;
- mbështetjen e parimeve në edukimin e përgjegjshëm, menaxhimin e sigurt dhe efektivitetin e zhvillimit, që janë standarde në hapësirën rajonale dhe globale;
- Angazhimin për të siguruar bashkëpunimin me të gjithë aktorët e arsimit dhe edukimit lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Programet e studimeve:

a. Bachelor

1. Banka dhe financa në biznes,
2. Menaxhment dhe ekonomiks,
3. Menaxhimi i Emergjencave,
4. Juridik i përgjithshëm;

b. Master

1. Menaxhment dhe financa,
2. Menaxhimi i emergjencave.

c. Qendrat Hulumtuese

1. Qëllimet e Mësimnxënies

Në Kolegjin "Biznesi", arsimimi i juaj bëhet për t'ju përgatitur për jetën tuaj pas diplomimit, punësimin dhe zhvillimin e karrierës.

Ju do të fitoni njohuritë, aftësitë dhe rrjetet e nevojshme të njohurive, për të ndërtuar me besim një karrierë të suksesshme.

Si student i diplomuar në Kolegjin "Biznesi", ju do të fitoni aftësi që të veproni në një botë të globalizuar dhe me ndryshime të shpeshta, që po ndodhin duke iu përshtatur mjedisit social dhe ekonomik.

Kurset tona janë të dizajnuara për të zhvilluar attribute që shkojnë më thellë dhe përtej rrethanave aktuale. Ato u krijojnë mundësi të të kuptuarit dhe të vepruarit me kompetencë për të përvetësuar një përmbajtje funksionale të karrierës.

Kolegji "Biznesi" i përgatit të diplomuarit e tij që të jenë:

1. Qytetarë të përgjegjshëm dhe efektivë në aktivizimin social dhe ekonomik vendor, rajonal dhe global, të cilët:

- angazhohen në një botë të ndërkombëtarizuar,
- shfaqin kompetencë ndërkulturore, dhe
- demonstrojnë vlera etike.

2. Studiues kritikë dhe krijues të cilët prodhojnë zgjidhje inovative për problemet, zbatojnë aftësitë kërkimore në një sërë sfidash, dhe komunikojnë në mënyrë perceptuese dhe efektive.

Çdo lëndë e mësimin në Kolegjin "Biznesi" ka syllabuset dhe informacionet përcjellëse, të cilat ju mund t'i lexoni në shënimet përmbajtësore në: webfaqe të Kolegjit.

Gjatë studimeve tuaja, do të vini re një theks specifik në këto objektiva të njoftimit dhe të mësuarit - ato janë referuar në çdo udhëzues të njësisë apo Degës ku ju studioni dhe mbështesin hartimin e detyrave të vlerësimit, që do t'u kërkohen gjatë periudhës së studimeve universitare.

Kolegji "Biznesi" monitoron efektivitetin e qasjes së periudhës së studimeve të drejtuar nga objektivat për mësimdhënien dhe të mësuarit përmes sigurimit të proceseve të të nxënimit të mësimin në mënyrë adekuate dhe përmbajtësore.

Siguria e mësimnxënies përcaktohet si "mbledhja e informacioneve edukative sistematike, si dhe rishikimi e përdorimi i informacionit në lidhje me programet arsimore që ofron Kolegji, me qëllim të përmirësimit të të mësuarit dhe zhvillimit adekuat të studentëve".

Në përputhje me standardet e vendosura nga AKA, Kolegji "Biznesi" merr përsipër vlerësimin e rregullt të punës së studentëve, me qëllim të përmirësimit të praktikave të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

Puna e deritanishme e përcakton Kolegjin "Biznesi" si institucion të arsimit të lartë shumë të përgjegjshëm për premtimet e tij, por ajo është edhe një mjet për të mbështetur punën në vijim në formën adekuate bashkëkohore, për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve tona arsimore.

Në kapitujt vijues të këtij manuali, në shpjegojmë ndikimet e këtyre praktikave të Kolegjit në procesin dhe zhvillimit dhe qasjen tuaj për të studiuar.

Profesorët dhe mentorët

Pedagogët dhe mentorët kanë një rol kryesor si nxitës dhe lehtësues të të mësuarit tuaj. Ata janë të aftë dhe gjithmonë të gatshëm për t'u ndihmuar në studimet tuaja. Me ata mund të kontaktoni personalisht në kontakte të drejtpërdrejta dhe duke përdorur llogarinë tuaj të emailit. Adresat e tyre elektronike zakonisht renditen në udhëzuesin e njësisë në website ose mund të merren në kontaktet e drejtpërdrejta në orarin e përcaktuar për konsultime.

Është e rëndësishme që këto marrëdhënie të përdoren në mënyrë të përshtatshme dhe të respektueshme. Kërkesat tuaja duhet të shprehen në mënyrë adekuate, kur të kontaktoni pedagogun ose mentorin tuaj.

Komunikimi nëpërmjet adresave elektronike është një kanal zyrtar komunikimi. Prandaj komunikimi në postat elektronike duhet të fillojë me "I nderuar".... Përveç kësaj, është e rëndësishme që të përfshini kodin tuaj studentor të njësisë në të gjitha postat elektronike, si dhe emrin e profesorit tuaj, kur dërgoni me email tek ligjëruesi.

Stafi akademik zakonisht mund të kontaktohet gjatë orëve të tyre të konsultimit të cilat mund të gjenden në udhëzuesin e njësisë ose Degës, në Moodle, të postuara në derën e tyre ose jashtë zyrës kryesore të administratës së Degës a njësisë përkatëse në hyrje.

Ju përkujtojmë se dy studentë kanë një mentor për konsultime dhe kërkesa të tjera për procesin e zhvillimit të veprimtarisë mësimore.

Roli i burimeve në internet

Kolegji "Biznesi" përdor sistemin e menaxhimit të të mësuarit Moodle në E-leraning, i cili ju ofron mundësinë e hyrjes në internet, për të marr informacionet e nevojshme, si ato me karakter mësimor apo administrativ, ashtu edhe material të dobishëm për studimet tuaja më të thelluara.

Uebfaqja e Kolegjit "Biznesi" përmban informacione më të gjera rreth Kolegjit për politikatat arsimore, mundësitë bashkëkurrikulare dhe të gjitha çështjet e tjera administrative.

Roli i shërbimeve të studentëve, drejtuesit e kurseve dhe koordinatorëve

Ekipi i Shërbimeve Studentore të Kolegjit "Biznesi" është ndalesa e parë për çdo pyetje në lidhje me ndonjë kërkesë tuajën të regjistrimit, këshillimit dhe rezultateve të provimeve dhe të kërkesave të tjera jashtë këtyre çështjeve. Ekipi administrativ shërbyes mund t'u ndihmojë të merrni informacione në kompleksitetin e politikave studimore dhe sistemet avancuese , dhe t'u ndihmojë me pyetje në lidhje me çështjet e performancës akademike, progresin e kursit, dhe probleme të ngjashme. Kur është e përshtatshme, për aktivitetin tuaj, ekipi i Shërbimeve Studentore do t'u referojë kontaktet me personelin, koordinatorët e kurseve (programeve) ose personelin tjetër përkatës.

Informacion shitesë i rëndësishëm

Informacione në lidhje me aspekte të ndryshme të jetës në Kolegjin "Biznesi", të tilla si: burimet e studimit, kursi dhe informacioni akademik dhe shërbimet mbështetëse, janë në dispozicion në internet në www.kolegjibzinesi.com

Një burim i shkëlqyer për studentët është në dispozicion përmes lidhjes së studentëve në Ekonomi, Emergjenca dhe Juridik.

Uebfaqja e Kolegjit në <http://kolegjibzinesi.com/Default.aspx?ID=1>.

Faqja përmban lidhje të rëndësishme, informacion në lidhje me kurset dhe njësitë, pranimet dhe regjistrimet e kërkesave, dhe degët e programet e studimore, provimet dhe rezultatet, administratën, për burimet e studimeve, kalendarët dhe oraret, IT dhe informatikë, shërbime mbështetëse, karrierë dhe punësim praktik, si dhe klube dhe shoqata si Alumni.

Pjesëmarrja dhe mbajtja e mësimit

Leksionet janë thelbësore për performancën tuaj si student.

Leksionet sigurojnë materialin e nevojshëm që duhet ta keni për nevoja tuaja për të kuptuar natyrën e përgjithshme dhe specifike të studimit.

Koncepte të rëndësishme dhe analiza mund të iu referohet nga pedagogu dhe të vihet në kontekst për ju. Në shumë njësi mësimore, disa ose i gjithë materiali i leksionit mund të gjendet në formatin video në Moodle. Kjo bën të domosdoshme pjesëmarrjen tuaj në leksione dhe të keni materiale të leksioneve rishikuese të siguruar në Moodle.

Klasat janë gjithashtu një pjesë jetike të studimeve tuaja. Ato përforcojnë materialin e leksioneve dhe ju ofrojnë një mundësi për të diskutuar materiale të prezantuara në leksione të drejtpërdrejta ose nëpërmjet internetit, si dhe për të bërë pyetje për të gjitha paqartësitë që mund të keni.

Ato gjithashtu ju sigurojnë mundësi për të zhvilluar aftësitë tuaja të komunikimit gojor. Materiali i paraqitur nuk është i dizajnuar vetëm për t'u dhënë një pamje mbi një temë por për t'u lehtësuar të kuptuarit e çështjes në diskutim. Kur ka pikëpamje alternative për një çështje, ju duhet të mësoni të artikuloni, qaseni në mënyrë kritike dhe vlerësoni këto pozicione të ndryshme.

Konsideratë e veçantë dhe zgjatja e afatit të dorëzimit për detyrën dhe vlerësimin

Nëse nuk jeni në gjendje të plotësoni një pjesë të detyrës ose të provimit për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, ju mund të aplikoni për një shans tjetër përmes shqyrtimit të veçantë, për të siguruar barazi dhe qasje të barabartë për të gjithë studentët.

Kolegji ka politika dhe procedura të qarta për shqyrtim të veçantë. Faqet e mëposhtme të internetit ofrojnë:

informacione kryesor: www.kolegjibzinesi.com

Nga studentët kur kërkoni një zgjatje të kohës për paraqitje të një detyre apo provimi, duhet të plotësohet një formular aplikimi. Arsyet që bëjnë të lejohet një veprim i tillë dhe që përfshijnë periudha afatshkurtra, janë disa rrethana përtej kontrollit të studentit, të tilla si sëmundja, aksidenti, trauma personale, çështje familja, situata emergjence ose dëmtimi etj. Aplikimet pasi krijoni bindje se duhen bërë, duhet të konsultohen me mentorin tuaj, koordinatorin, bartësin e programit, pedagogun e lëndës ose personelin përgjegjës për vlerësimin e kërkesës dhe ofrimin e qasjes në procedurën e mëtejshme.

Ngarkesa e punës

Për të qenë i suksesshëm, do të duhet t'i kushtoni një kohë të konsiderueshme studimeve vetjake jashtë orëve mësimore.

Kjo kohë duhet të kalohet duke lexuar, duke u përgatitur për leksione dhe orë pune praktike, duke përgatitur e ushtruar detyrat etj. Ndërsa më shumë orë mësimore duhet t'i kaloni në një model të 'orët dhe leksionet e shfletuara', është thelbësore që të shikoni paraprakisht programin dhe lëndët, mjetet dhe literaturën para secilës orë mësimore, në mënyrë që të përfitoni në mënyrë sa më adekuate nga qasja studentit në qendër të të mësuarit.

Mbështetja në vetvete

Në Kolegj pritet të jeni më të pavarur dhe të mbështetur në vetvete sesa gjatë periudhave të mëparshme të përvojës tuaj të shkollimit të deritanishëm. Në ndryshim nga mësuesit në shkollë, në Kolegjin "Biznesi" jep mësim një numër i madh profesorëve, ligjëruesve dhe asistentëve, që përbëjnë personelin akademik dhe zakonisht janë të angazhuar në secilën njësi të programit. Ata janë të lumtur t'ju ndihmojnë, kur ju keni nevojë dhe i drejtoheni anëtarit përkatës të stafit akademik dhe jeni të qartë për atë që dëshironi të diskutoni me ata.

Si një student i pavarur, përgjegjësia juaj është gjithashtu, që të merrni pjesë rregullisht në ligjërata dhe orët e mësimit sipas kërkesave të programit. Njëkohësisht është e nevojshme të bëni punën përgatitore, dhe dorëzimin e të gjitha detyrave për t'u vlerësuar në kohë.

Menaxhimi i kohës

Si student i Kolegjit "Biznesi", ju duhet të mësoni të menaxhoni kohën tuaj. Kjo vlen për faktin se studentët kanë një kohë të madhe në dispozicion jashtë orëve të planifikuara. Prandaj atyre u duhet të ekuilibrojnë angazhimet e tyre, duke kryer si angazhimet familjare ashtu edhe studimin.

Vlerësimi në një njësi studimi (lëndë mësimore të programit) zakonisht do të përmbajë disa aktivitete të detyrueshme për studentin, të tilla si: rishikime, ligjërata, detyra, ese, kullokfiume dhe provime zyrtare.

Rishikime të literaturës, teste në internet me zgjidhje të shumëfishta, raporte, analiza të rasteve ose prezantime gojore. Këto janë vetëm disa shembuj të asaj që mund të kërkohet. Cilado qoftë detyra e dhënë, është jetike që të lexoni dhe kuptoni saktësisht se çfarë ju kërkohet të

paraqisni. Detajet e të gjitha detyrave të vlerësimit për secilën njësi jepen në udhëzuesin e njësisë, në të cilin do të keni qasje nga java e parë e secilit semestër. Nëse akoma nuk jeni të sigurt për kërkesat dhe keni nevojë për sqarim, kërkoni këshilla nga bartësit e programit dhe profesorët tuaj: mentori ose ligjëruesi. Kur ka punë në grupe në një njësi mësimore, pritet që ju të menaxhoni grupet tuaja dhe detyrat e grupit në mënyrë efektive.

Një standard i lartë i integritetit dhe ndershmërisë pritet nga ju në përfundim të detyrave tuaja.

Çdo formë mashtrimi, të tilla si plagjiaturë, kuazi-bashkëpunimet ose 'blerja e një eseje', do të penalizohen nën procedurat e Disiplinës Studentore të Kolegjit. Asnjëherë nuk ia vlen të rrezikoni. Gjithmonë kryeni punën tuaj, punoni në maksimumin e aftësive tuaja dhe planifikoni kohën tuaj me kujdes.

Nota përfundimtare që një student merr në një kurs/lëndë do të përcaktohet nga profesori, Krye-ekzaminuesit, duke marrë parasysh të gjitha aspektet e vlerësimit (pjesëmarrjen në orët mësimore, inter-aktivitetin, detyrat e kryera, idetë tuaja përmes eseve e të tjera). Proceset për të kërkuar rishikime të rezultateve ose vërejtjeve të punës për me tepër mund të merrni informacion këtu: <http://www.kolegjbiznesi.com>

Kolegji "Biznesi" ka procedura të përcaktuara, për të siguruar, që studentët të regjistrohen në mënyrë të drejtë dhe saktë në regjistër të mësimit, proces që mbikëqyret nga bartësit e programeve dhe dekani. Ky është veçanërisht rasti pas participimit në provime ku çdo dështim i mundshëm duhet të shënohet nga profesori dhe asistenti dhe gjithë stafi akademik sipas përkatësisë, për të konfirmuar që një notë kaluese/dështimi është e përshtatshme për njohuritë e prezantuara.

Të gjitha rezultatet mësimore rishikohen nga Dekani, profesori dhe asistenti i lëndës apo bashkëpunëtori tjetër mësimor, të dhënat e tjera orientuese gjenden në websin e Kolegjit "Biznesi".

Provimet

Për detaje të rregulloreve të provimit, ju lutemi referojuni orarit elektronik ose figurativ në ekranet vizuale të Kolegjit.

Nga studentët gjatë provimeve zyrtare pritet standardi më i lartë i sjelljes së ndershme.

Nuk duam të ketë studentë që të kapen duke mashtruar gjatë provimeve, gjë që çon në procedura zyrtare të disiplinës. Kjo është një çështje shumë serioze dhe përfundon me ndëshkime të rënda, të tilla si largimi ose pezullimi nga Kolegji.

Rezultatet

Në fund të çdo semestri, pas përfundimit të provimeve, vihet në veprim një ekip (Bord) i vlerësimit të provimeve. Takimi i tij mbahet për të konfirmuar rezultatet, duke marrë parasysh performancën e studentit në tërësi. Rezultatet e konfirmuara më pas publikohen brenda datës së caktuar në kalendarin e veprimtarive kryesore të Kolegjit "Biznesi". Studentët që kalojnë, vlerësohen në kategoritë (notat) 6-10.

Qasja në mësimnxënie

Studimi i suksesshëm në Kolegj kërkon të njëjtin lloj angazhimi dhe përpjekjeje që kërkohet për një punë me kohë të plotë. Kjo nënkupton kultivimin e pavarësisë dhe marrjen e pronësisë autoriale dhe përgjegjësisë për të mësuarit, veçanërisht në drejtim të menaxhimit të kohës tuaj; në balancimin e studimit tuaj me angazhime të tjera; në zhvillimin e një qasje efektive për të mësuarit etj.

Në këtë kapitull, ne diskutojmë rëndësinë e vetë-mbështetjes dhe të mësuarit aktiv si cilësi thelbësore për sukses në Kolegj. Ne i konsiderojmë disa nga qasjet e ndryshme të mësimdhënies dhe të të nxënit, si dhe aktivitete që ka të ngjarë të hasni nga ditët e para e deri te diplomimi juaj, të një rëndësie të veçantë për ecurinë tuaj dhe suksesin në përfitimin e njohurive për të marrë aftësitë e dëshiruara.

Të bëheni student aktiv në mësimnxënie

Si student në Kolegjin "Biznesi", do të sfidoheni për të lëvizur përtej thjesht të mësuarit përmendësh dhe duke përshkruar informacionin dhe faktet. Çdo njësi e ofruar nga Kolegji "Biznesi" u mëson se si të përdoret procesi kritik dhe analitik i të menduarit, si individ dhe si anëtar i një ekipi. Kjo ju përgatit për botën e punës dhe studimin e mëtejshëm, sepse këto njohuri janë jetike për aftësimin tuaj për suksesin dhe inovacionin punues gjatë jetës tuaj.

Brenda secilës njësi, ju gjithashtu do të mësoni të komunikoni qartë, me besim dhe në mënyrë të përshtatshme për një larmi të gjerë audiencash.

Për këto arsye, Kolegji "Biznesi" gjithnjë e më shumë do t'u mbështesë në mënyra aktive, bashkëpunuese të mësimdhënies dhe të nxënit, të cilat përfshijnë detyra të bazuara dhe ekipore si dhe aktivitete të tjera për përfitime maksimale. Synoni të angazhoheni në mënyrë aktive në procesin e të nxënit në njësinë mësimore.

Përparimet dhe inovacioni në fusha të veçanta të studimit ndodhin përmes kërkimeve sistematike dhe hetimit e hulumtimit përmbajtësor.

Njohuritë evoluojnë ndërsa studiuesit i sfidojnë, konfirmojnë dhe modifikojnë përvojat e kuptimeve të mëparshme.

Kjo njihet si kërkim dhe zbulim akademik. Ju gjithashtu do të angazhoheni në këtë proces kur të integroheshi dhe zbatoni njohuritë, konceptet dhe teoritë si pjesë e procesit tuaj të të mësuarit.

Kur heton një çështje për një detyrë që bazohet në prova dhe literaturë, ti duhet të rishikosh dhe integrosh një sërë perspektivash. Të demonstroi vet se si mund të bëhet një temë e vetme, mbështetur në prova e literaturë që rezultojnë në pozicione të ndryshme. Kur të keni formuar përgjigjen tuaj dhe të keni strukturuar punën tuaj me shkrim, shprehni këtë. Ju duhet t'i tregoni lexuesit tuaj, se si keni arritur në atë pikëpamje a keni dalë në ato përfundime.

Idetë dhe pikëpamjet që ju lexoni në literaturë funksionojnë si blloqet ndërtuese të përgjigjes tuaj. Në shkrimet tuaja, mos i shpjegoni lexuesit tuaj vetëm provat që ju kanë çuar në pikëpamjen tuaj, po shprehni vetëm ato mendime, opinione që janë ide të bazuara nga provat dhe

nuk janë gjithmonë relevante dhe të vlerësuara përfundimisht sepse një inovacion mund të rrëzohet nga një inovacion tjetër nga ju.

Mendimi Kritik

Mendimi kritik dhe analitik ju mundëson të merrni një qasje objektive ndaj njohurive, koncepteve dhe të teorive. Kjo do t'ju lejojë të:

- integroni ide të kundërta ose edhe konfliktuale nga një sërë burimesh;
- përcaktoni ose përmirësoni pozicionin tuaj për një çështje ose temë;
- arsyetoni njohuritë dhe shpjegoni se si pjesët punojnë së bashku (analizë);
- vlerësoni pikat e forta, të dobëta, avantazhet dhe disavantazhet e njohurive (qasja kritike).

Ky theksim mund të ndryshojë nga mënyra se si i jeni afruar studimit në të kaluarën. Për shembull, më parë ju mund të keni pritur që të ketë një përgjigje të drejtë, ose vetëm dy anët e një çështjeje ose teme. Në Kolegj, nga ju pritet të eksploroni shumë këndvështrime, t'i sintetizoni këto dhe të inkorporoni idetë tuajat dhe perspektivat. Kjo do t'u mundësojë të arrini në vendimet dhe gjykimet tuaja të qëndrueshme dhe të arsyetuara.

Duke menduar në mënyrë kritike, ka qasje ose pyetje të ndryshme, që duhet të merrni parasysh kur shqyrtoni literatura për një temë të veçantë.

1. Identifikoni argumentin:

- Cila është pika kryesore e autorit?
- A përdor autori gjuhë emocionuese apo të njëanshme?
- Çfarë po ju kërkon të pranoni ose supozoni autori?

2. Identifikoni se si përdoren provat:

- A e krahason autori një situatë me një tjetër?
- A zbaton autori një parim të përgjithshëm për një rast specifik?
- A është i zbatueshëm parimi?
- A rekomandon argumenti një veprim të veçantë?
- A do të kishte ndonjë veprim të padëshirueshëm ky veprim?

3. Identifikoni fjalët e paqarta:

- A u mungojnë përkufizimet e ndonjë fjale?
- A përdoren ato fjalë vazhdimisht?

Ky proces ju lejon të krijoni një argument ose tezë unike dhe ofron prova për të justifikuar pozicionin tuaj. Pasi të keni parë materialin në mënyrë kritike, atëherë mund të konsideroni se si funksionojnë këto faktorë në procesin e punës tuaj për punimin e studimit ose veprës.

Aftësia për të lexuar dhe shkruar në mënyrë kritike tregon se ju jeni të shquar dhe të aftë të arsyetoni gjykimet e bazuara në prova dhe argumente. Kjo tregon se ju i kuptoni konventat akademike.

Shumë studentë mund të ndihen të pakëndshëm nga 'ekspertët' pasi duke pyetur u shtojnë ngarkesën, por si student i Kolegjit, ju jeni një anëtar fillestar i një komuniteti global të studiuesve,

të përbërë nga akademikë dhe studiues, prandaj duhet të pyesni. Në vijim pritet që duke menduar, lexuar dhe shkruar në mënyrë kritike, shihet se nuk janë më të përshtatshme konventat akademike.

Çasja në mësimdhënie dhe mësimnxënie

Mësimdhënia dhe të nxëniti menaxhohen në mënyra të përshtatshme. Në studimet e programeve që ndjekin studentët në Kolegjin "Biznesi", përdoren metoda më tradicionale, me në qendër studentin, duke përfshirë leksione dhe udhëzime. Disa profesorë ofrojnë një metodë të orës mësimore ku ju së pari drejtoheni përmes mësimi në internet, para se të merrni pjesë në orën e mësimi.

Aktivitete të të nxëniti të mësimi "studenti në qendër" në një mjedis ore mësimi është ndërveprues, dhe fokusi i qasjeve të mësimdhënies dhe të nxëniti që mund të hasni duhet të përcaktoheni për mënyrën me fleksibile për mësimnxënie.

Pedagogu kërkon që studentin të marrë përgjegjësinë për përgatitjen për të mësuar, edhe para se të ndjekë një orë mësimi.

Cilado qoftë qasja, rishikimi i qëndrueshëm nga ju është thelbësor për procesin e të mësuarit dhe duhet të përcaktoheni para se të fillojë ora e juaj e mësimi.

Mënyra e mësimi

Ka shumë forma të ndryshme të të mësuarit. Ju mund të preferoni një qasje vizuale, përdorimin e materialit dëgjimor ose një metodë tjetër. Ju mund të keni nevojë për ambiente të qeta në të cilat do të studioni, ose mund të preferoni të dëgjoni muzikë, përderisa punoni. Ju mund të gjeni më së miri në internet përgjigjen për materialet e shkruara rreth materialeve mësimore për orët e mësimi.

Mund të jetë më e dobishme të filloni studimin tuaj nga perspektiva e gjerë ose globale e temës. Përndryshe, ju mund të preferoni të filloni me detajet dhe të ndërtoni prej andej një pamje globale. Është e dobishme të provoni mënyra të ndryshme të të mësuarit, për të zgjeruar qasjen tuaj të studimit.

Pavarësisht nga preferencat tuaja, ju duhet të jeni të pavarur derisa të vendosni se çfarë funksionon më mire për ty. Merrni parasysh se si një qasje e veçantë ju ndihmon të studioni më mirë. Reflektimi mbi rezultatet e vlerësimit dhe reagimet nga anëtari i stafit akademik që shënon punën tuaj do ta ndihmojnë në këtë proces.

Puna e pavarur dhe mbështetja e vetja, do të thotë gjithashtu që ju duhet të njihni atë që nuk po funksionon për ju dhe të kërkonin ndihmë.

Ndërsa profesorët paralajmërojnë studentët për fushat në të cilat kërkohet përmirësim, në fund të fundit është përgjegjësia e studentit të reflektojë në këtë reagim dhe përgjigjet siç duhet. Nëse keni nevojë për ndihmë të mëtejshme, vizitoni Bibliotekën Digjitale të Kolegjit.

Pika e kërkimit dhe mësimi do të jetë një hap i parë i mirë. Kërkimi në faqen e internetit të Kolegjit do të sigurojë gjithashtu informacion në lidhje me shërbimet e tjera të nevojshme për studentët gjatë procesit të mësimi.

Mësimnxënia në disiplinën e caktuar

Në vazhdimësi gjatë studimit tuaj, do të kuptoni se qasjet ndaj njohurive në disiplina të ndryshme të studimeve në Kolegjin "Biznesi" ndryshojnë në disa mënyra të përshtatshme për ju. Kuptimi i një variacioni të tillë do t'u ndihmojë të rregulloni ndryshimet tuaja të të menduarit dhe qasjen në të gjitha njësitet (lëndët) tuaja të studimit. Kjo është veçanërisht e zbatueshme nëse jeni student i regjistruar, pra duke studiuar edhe në ndonjë fakultetet tjetër, veçmas për shembull, kur jeni duke studiuar në një njësi të vitit të parë të drejtësisë, ekonomisë, apo emergjencave. Mënyra se si ju qaseni, mendoni dhe strukturoni informacionin, do të jetë e ndryshme nga mënyra se si ju qaseni në menaxhim të kohës. Ju keni mundësi të përdorni forma të ndryshme të të dhënave dhe provave, dhe duke aplikuar mendime kritike, analiza në mënyra që janë të veçanta për njësinë dhe disiplinën e saj.

Për të zhvilluar një analizë të kuptueshme, duhet të mendoni për njësitet tuaja në terma si në vijim:

- llojin e të dhënave dhe informacionit të përdorur;
- mënyra se si integrohen, analizohen dhe kritikohen të dhënat dhe informacionet;
- mënyrën e përdorimit të të dhënave dhe informacionit si dëshmi në adresimin e çështjeve dhe temave;
- mënyrën e paraqitjes së të dhënave dhe informacionit në formë të shkruar.

Kjo do t'ju ndihmojë të zhvilloni qasjen tuaj dhe të siguroni që ajo është karakteristike e disiplinës suaj.

